

Fondi i Pensionit Privat Raiffeisen



Rapor Müjor Janar 2025

Informacion bazë

Administrimi i Fondit

Monedha
Vlera fillestare e kuotës
Shuma fillestare minimale
Shuma minimale pasuese

Komision në hyrje
Komision në dalje
Penalite ne rast terheqje te
parakohshme

Komision Administrimi ne vit
Kosto per transferte fondesh
nga pale te treta

Shoqëria

Raiffeisen Invest

sh.a

LEK

1,000

1,000

1,000

0%

0%

Sipas rregullores
se AMF-se

1.50%

Referojuni
informacionit ne
deget e RBAL



Objektivi i investimit dhe profili i investitorit

Fondi i Pensionit Privat është një mënyrë alternative kursimi, e përdorur ekskluzivisht për kursime afatgjata për vitet pas largimit përfundimtar nga puna. Ky fond zotërohet bashkërisht nga anëtarët e fondit dhe menaxhohet nga Shoqëria Administruese Raiffeisen Invest sh.a, në bazë të kontratës së lidhur me anëtarët e fondit.


Asetet e Fondit do të investohen sipas parimit të sigurisë afatgjatë dhe të një kthimi të përshtatshëm nga investimi, duke ruajtur një raport optimal mes rritjes së kursimeve për pension dhe riskut të marrë përsipër.

Fondi synon të ndërtojë një portofol të përbëre kryesisht nga tituj borxhi te emetuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë me maturim afatgjatë (me maturim më të lartë se një vit).

Profili i Rikut dhe Përfitimit

Risk i ulët
Përfitimet tipike më të ulëta

Risk i lartë
Përfitimet tipike më të larta



Fondi është në kategorinë e parë të Profilit të Riskut dhe Përfitimit, pra në kategorinë me risk më të ulet.


Treguesi i riskut dhe përfitimit korrespondon me një numër të plotë i cili përdoret për të renditur fondin në një nivel rishku nga 1 në 7, sipas nivelit të rritjes së luhatshmërisë. Kategoria më e ulët nuk do të thotë që investimi në fond është pa risk. Ky tregues ka për qëllim tju informoje mbi luhatshmërinë e çmimit të kuotës së fondit bazuar në historikun e performancës se fondit. Të dhënat historike të përdorura për llogaritjen e treguesit nuk mund të përbëjnë një siguri të plotë për profilin e riskut në të ardhmen.

Të dhëna për Fondin në 31.01.2025

Vlera Neto e Aseteve	1,686,349,282
Numri i investitoreve	4,631
Cmimi i Kuotes	2,252.322
*Kthimi vjetor nga investimi (31.01.2024 - 31.01.2025)	4.61%

*Tarifa e administrimit dhe tarifat e tjera te vazhdueshme zbriten përparrë llogaritjes së kthimit nga investimi

Struktura e portofolit te investimeve ne 31 Janar 2025



Ne kuader te politikes se investimit te fondit te Pensionit, investimet do te kryhen kryesisht ne bono thesari dhe obligacione, te emetuara ne tregun primar, duke patur parasysh qe aktiviteti i tregtimit te titujve te borxhit te emetuar nga Qeveria shqiptare ne treg sekondar eshte i kufizuar.

Instrumenti	Ne % te Aseteve te Fondit
Obligacione Thesari	99.38%
Depozita / Llogari rrjedhese	0.62%

Bonot e thesarit 12 mujore emetohen dy here ne muaj; Obligacionet 2 vjeçare nje here ne muaj; 10 dhe 15 vjeçare jane me te rralla, afersisht nje here ne tre muaj. Qeveria organizon ankande te obligacioneve referencë 5 dhe 3-vjeçare me frekuence nje here ne muaj per secilin maturitet. Strategjia e investimeve vazhdon te jete e fokusuar ne investime afatgjate.

Vlera neto e aseteve te fondit eshte rreth LEK 1.69 miliard ne date 31 Janar 2025.

Zhvillimet dhe ecuria e normave te interesit te titujve te Qeverise Shqiptare gjate muajit Janar


Asetet e Fondit Pension jane te investuara ne bono dhe obligacione te emetuara nga Qeveria e Republikes se Shqiperise dhe per kete arsyte fondi eshte i eksposuar ndaj ndryshimeve ne normat e interesit te ketyre titujve. Investimet impaktohen kryesisht nga zhvillimet ne tregun e brendshem sic jane ndryshimet ne normat e interesit te titujve te Qeverise Shqiptare.

Normat e interesit te titujve te emetuar nga Qeveria Shqiptare kane ndjekur nje trend renes gjate muajit Janar, pervec bonos 12 mujore. Keshtu Yieldi i Bonos se Thesarit 12-mujore rezultoi ne 2.812%, duke u rritur me 0.06% ne krahesim me ankandin e muajit Dhjetor.

Persa i perket obligacioneve ne krahesim me ankandet e fundit: Yieldi i obligacionit 2 vjeçar rezultoi ne 3.04% duke rene me 0.34%; Yieldi i obligacionit reference 3 vjeçar rezultoi ne 3.392% duke rene me 0.05% dhe yieldi i obligacionit reference 5 vjeçar rezultoi ne 3.73% duke rene me 0.18% dhe Yieldi i obligacionit 10 vjeçar rezultoi ne 5.25% duke rene me 0.68%.

Per here te pare eshte zhvilluar ankandi i obligacionit 20 vjeçar, yieldi i te cilit rezultoi ne 6.78%.

Grafiket me poshtë jepin një pasqyre te ecurise se normave te interesit te bonove dhe obligacioneve te thesarit te emetuar nga Qeveria Shqiptare gjate periudhes 1-vjeçare Janar 2024 – Janar 2025. Per obligacionet reference 3 dhe 5 vjeçare janë paraqitur yield-et fiksë te perllogaritura nga kuotimet e kontributoreve ne fund te muajit Janar.



Performance e fondit dhe ecuria e çmimit të kuotës deri në 31 Janar 2025


Kthimi vjetor neto i fondit eshte **4.61%** per periudhen 31 Janar 2024 – 31 Janar 2025;

Kthimin 10 vjeçar me baze vjetore fondi e ka 5.23%, ndersa kthimin qe nga lancimi e ka 5.93% me baze vjetore.

Çmimi i kuotes se Fondit te Pensionit ka ndjekur një trend rrites dhe vlera e kuotes eshte rritur me **+0.37%** gjate muajit Janar. Kthimi i fondit ndryshon ne varesi te kushteve te tregut, sic janë ndryshimet ne normat e interesit te titujve te Shtator.


Rritja e normave te interesit te titujve te Qeverise do te ndikoje pozitivisht ne performancen e fondit te Pensionit, i cili mund te investoje me norma me te larta duke rritur kthyeshmerine e portofolit te investimit ne te ardhmen.

Ecuria e çmimit të kuotës Fondi i Pensionit Privat Raiffeisen



Ne 31 Janar 2025	1 Vit	3 Vjet	5 Vjet	7 Vjet	8 Vjet	10 Vjet	Qe nga lancimi i fondit (31 Dhjetor 2010)
Ne % kthim vjetor i periudhes (p.a.)	4.61%	4.41%	4.39%	4.63%	4.76%	5.23%	5.93%

Kthimi vjetor historik i Fondit te Pensionit Privat Raiffeisen per çdo vit



Anetaret e fondit te Pensionit keshillohen te kene një horizont sa me te gjate qendrimi ne fond (mundesisht deri ne moshen e pensionit, pese vjet para moshes se percaktuar ne Ligj) per te perfituar një kthim maksimal nga investimi, per te permiresuar standartin e jetesës ne moshen e pensionit dhe per te evituar penalitetet ne rast terheqje te parakohshme.

Të dhënat e kthimit nga investimi në të shkuarën janë vetëm illustrative dhe nuk përfaqësojnë një premtim apo garanci per kthimin ne te ardhmen. Te gjithe shembujt e tjere numerike, janë perdorur per qellime illustrative dhe analize te te dhenave historike, dhe nuk duhen perdorur nga investitorët per te nxjerre konkluzione per te ardhmen.

Investitorët e mundshëm duhet të lexojnë Prospektin dhe Rregullat e Fondit. Raiffeisen Invest dhe forca shite e fondit nuk garantojnë një kthim te caktuar te fondit. Informacioni mbi çmimin e përditësuar të kuotës, prospektin dhe rregullat e Fondit gjendet pranë zyrave të Raiffeisen Invest sha, në web site www.raiffeisen-invest.al, ose në degët e Raiffeisen Bank në Shqipëri.